



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË –KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE



	REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE DIREKTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU	
Nr.faq/Br.istr. 208		
Data/Datum: 31.10.2018		
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE		

Ekstrakt nga procesverbali i mbledhjes së nëntë IX - të, e jashtëzakonshme, e Kuvendit të Komunës, e mbajtur më datë 10.10.2018, ora 09:00h, në sallën e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës.

Prezentë në mbledhje ishin anëtarët e Kuvendit të Komunës: Vjollca Konjusha - Kryesuese e Kuvendit të Komunës, Remzi Shala, Ilir Hasani, Arjeta Jashari, Mirvete Gërguri, Jetmir Berisha, Albert Jasharaj, Miranda Shabani, Sabit Bullatovci, Betim Ahmeti, Sabri Rexhepi, Ali Zogiani, Durim Hajra, Eglantina Azemi, Doruntina Jashari, Aida Alimi, Arjana Zogjani, Naser Graiçevci, Migjen Kolshi, Mehdi Lahu, Shaban Ademi, Driton Ademi, Ali Ismaili, Driton Hasolli, Qerim Gara, Bashkim Krasniqi dhe Ljubisa Qirkoviq.

Kryetari i Komunës dhe Drejtorët e Drejtorive të Komunës: Burim Berisha - Kryetar i Komunës, Fadil Krasniqi - Nënkyetar i Komunës, Halil Qerimi - Nënkyetar i Komunës për Komunitete, Ekrem Berjani - Drejtor i Zhvillimit Ekonomik, Jakup Tërnavë - Drejtor i Gjeodezisë, Kadastrit dhe Pronës, Afrim Krasniqi - Drejtor i Inspektoratit, Nuriye Avdiu - Drejtorë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Maliq Berisha - Drejtor i Shërbimeve Publike dhe Mjedisit.

Të tjerë: Përfaqësuesit e OSBE-së, KFOR-it, qytetarë dhe mediat.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës përshëndeti të pranishmit në mbledhje, pas verifikimit të prezencës së anëtarëve të Kuvendit të Komunës, konstatoi se ekziston kuorumi për mbajtjen e mbledhjes së jashtëzakonshme dhe prezantoi këtë:

REND DITE

1. Propozim për bartjen e pronave shoqërore në pronësi të Komunës së Fushë-Kosovës.
2. Propozim për arritjen e marrëveshjes për ndryshimin e kufijve kadastral në mes të Komunës së Fushë-Kosovës dhe Komunës së Graçanicës.
3. Propozim për formimin e Komisionit për ndarjen e nxënësve sipas lagjeve dhe rrugëve për vijueshmërinë e mësimi në shkollat e qytetit.
4. Propozim për shqyrtimin e kërkesës së Organizatës 'Terre des Hommes' për Qendrën Ditore për mbrojtjen e fëmijëve me qëndrim në rrugë.

Pasi që diskutime tjera nuk pati, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës ftoi anëtarët e Kuvendit të Komunës që të votojnë për aprovimin e rendit të ditës së propozuar.

U votua me: pesëmbëdhjetë vota 'për', një 'kundër' dhe shtatë abstenime, gjithsej njëzet e tre (23) anëtarë.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me shumicë të votave, e aprovoi rendin e ditës së propozuar.

Pika e parë (1) - Propozim për bartjen e pronave shoqërore në pronësi të Komunës së Fushë-Kosovës.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për pronat shoqërore që gjenden në territorin e komunës dhe janë shumë të nevojshme për ne si komunë që të ndërtojmë objekte të infrastrukturës shoqërore, si: shkolla, ambulanca', etj. Ftoj Ekzekutivin e Komunës që të na jap sqarime.

Nënkryetari e Komunës: Komuna e Fushë-Kosovës ka pak prona komunale dhe ka vendosur që t'i drejtohet me një kërkesë Qeverisë së Republikës së Kosovës që pronat shoqërore t'i bart në prona komunale për rregullimin e infrastrukturës publike, siç janë: shkollat, ambulancat, parqet, etj. Kjo iniciativë ka dalë pas një takimi që kemi pasur përfaqësuesit e komunave me Kryeministrin e Kosovës, z. Ramush Haradinaj, lidhur me bartjen e pronave shoqërore në pronësi të komunës përmes një vendimi të Qeverisë së Kosovës. Kërkesën tonë ne e kemi adresuar në Qeverinë e Kosovës dhe Agjencinë Kosovare të Privatizimit që menaxhon me pronat shoqërore.

Durim Hajra: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje e mbështet 'Propozimin për kalimin e pronave në pronësi të Komunës së Fushë-Kosovës', në mënyrë që ato të jenë në funksion të plotësimit të kërkesave të qytetarëve. Ne çdo herë e kemi kërkuar listën e pronave të komunës në mënyrë që të dimë se ku gjenden këto prona, kjo e drejtë rrjedh nga Ligji për Vetëqeverisje lokale.

Driton Ademi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Thirrja e kësaj mbledhje nuk i plotëson kushtet për të qenë mbledhje e jashtëzakonshme sepse kjo çështje nuk është urgjente sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale! Këtu nuk dihet a është thirrur mbledhja nga Kryetari i Komunës apo nga një e treta e anëtarëve të Kuvendit të Komunës! Arsytimi i propozimit nuk është i bazuar në ligjin përkatës dhe është shumë i cekët.

Remzi Shala: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës e përkrahim 'Propozimin e Kryetarit të Komunës që pronat shoqërore në qytetin e Fushë-Kosovës të barten në pronësi të Komunës së Fushë-Kosovës për plotësimin e nevojave të përgjithshme publike për qytetarët e komunës sonë'.

Aida Alimi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Në parim ne jemi për bartjen e këtyre pronave në pronësi të Komunës për ndërtimin e: shkollave, qendrave të mjekësisë familjare, parqeve, etj. Por si mund të bëhet kjo, kur ne si komunë nuk kemi mundësi ta rrisim numrin e mjekëve dhe mësuesve, meqë nuk e kemi bërë regjistrimin e popullsisë dhe nuk i kemi bërë një analizë të thellë këtij problemi! Andaj ne do të abstenojmë.

Shaban Ademi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Nuk mund të ketë asnjë njeri të arsyeshëm që është kundër bartjes së pronave shoqërore në pronësi të komunës, nëse ato përdoren për destinimin e propozuar për ndërtimin e çerdheve, shkollave, qendrave të mjekësisë familjare, mirëpo ne nuk e kemi një analizë të mirëfilltë për ndërtimin e këtyre objekteve publike! Shpresojmë që këto prona nuk do të përfundojnë në ndonjë destinim tjetër për të cilin ne nuk pajtohemi! Të shpresojmë që Qeveria e Kosovës do të pranojë kërkesën tonë.

Ali Ismaili: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë pajtohem me mendimet e parafolësve se bartja e këtyre pronave në pronësi të Komunës është në dobi të interesave të qytetarëve. Për 4 vite ne kemi kërkuar që të na dorëzohet lista e pronave komunale por kjo nuk është bërë! Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës ne nuk e kemi një elaborat të mirëfilltë nga Drejtoria e Gjeodezisë, Kadastrit dhe Pronës për të ditur se ku gjenden këto prona dhe vijmë në vështirësi të paarsyeshme,

sikurse në mbledhjen e kaluar që kërkohej nga ne të merrnim vendim për pronën e uzurpuar e cila është dashur të lirohej! Ne e mbështesim për aprovim propozimin në fjalë, meqë është në interesin e qytetarëve dhe pyes, a ka prona shoqërore që duhet të kthehen në pronësi të komunës edhe nëpër fshatra?

Kryetari i Komunës: Përshtendes të pranishmit në mbledhje. Këtë Kuvend e kam thirrur unë meqë kemi të bëjmë me disa pika shumë të rëndësishme për Komunën tonë. Lidhur me pronat shoqërore i kam dërguar një shkresë zyrtare Qeverisë së Kosovës, ata kanë kërkuar që së pari të merret vendim nga ana e Kuvendit të Komunës. Do të ishte jetike për ne që këto prona shoqërore të kalojnë në pronësi të komunës sonë. Tani për tani, këto prona janë në menaxhimin e AKP-së, mirëpo përmes Agjencisë Kadastrale të Kosovës pritet të kalojnë në nivel lokal. Te 'Kompleksi 300' janë tre hektarë ku do ta ndërtojmë shkollën, një qendër të mjekësisë familjare të re dhe palestrën sportive, që siç e dini nuk është pranuar të ndërtohet nga investitori në fshatin Miradi e Poshtme. Realizimin e kësaj pune ne e kemi kërkuar që të kryhet qysh në kohën e Kryeministrit Isa Mustafa, por kjo nuk është kryer. Mjetet për ndërtimin e shkollës i kemi, në të ardhmen pritet ta ndërtojmë edhe një shkollë të re ndërmjet Uglarit dhe Fushë-Kosovës dhe ta zgjidhim problemin e hapësirave shkollore për një kohë më të gjatë. Kjo do të ishte në rregull, nëse propozimi ynë përkrahet nga Qeveria e Kosovës dhe ne i marrim këto prona shoqërore!

Pas sqarimeve, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim 'Propozimin për bartjen e pronave shoqërore në pronësi të Komunës së Fushë-Kosovës'.

U votua me: njëzet e katër vota 'për', asnjë 'kundër' dhe dy abstenime, gjithsej njëzet e gjashtë anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me shumicë të votave, e aprovoi 'Propozimin për bartjen e pronave shoqërore në pronësi të Komunës së Fushë-Kosovës' dhe mori:

V E N D I M

1. Për aprovimin e 'Propozimit Nr. 1434, të datës 05.10.2018 për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik për bartjen e pronësisë së Ngastrave Kadastrale nga prona shoqërore në pronësi të Komunës së Fushë-Kosovës', si vijon:
 - 1.1 Ngastra Kadastrale Nr. 00589-211, në sipërfaqe prej 02.98.47ha, në pronësi të P.sh. Kosova Eksport - N.sh. Bujqësia, në Zonën Kadastrale Fushë-Kosovë;
 - 1.2 Ngastra Kadastrale Nr. 01081-28, në sipërfaqe prej 00.28.88ha, në pronësi të P.sh. Kosova Eksport - N.sh. Bujqësia, në Zonën Kadastrale Fushë-Kosovë;
 - 1.3 Ngastra Kadastrale Nr. 01081-35, në sipërfaqe prej 00.36.05ha, në pronësi të P.sh. Kosova Eksport - N.sh. Bujqësia, në Zonën Kadastrale Fushë-Kosovë;
 - 1.4 Ngastra Kadastrale Nr. 01081-42, në sipërfaqe prej 00.26.83ha, në pronësi të P.sh. Kosova Eksport - N.sh. Bujqësia, në Zonën Kadastrale Fushë-Kosovë;
 - 1.5 Ngastra Kadastrale Nr. 00149-2, në sipërfaqe prej 00.94.46ha, në pronësi të P.sh. Kosova Eksport - N.sh. Bujqësia, në Zonën Kadastrale Fushë-Kosovë;
 - 1.6 Ngastra Kadastrale Nr. 00149-3, në sipërfaqe prej 00.04.64ha, në pronësi të P.sh. Kosova Eksport - N.sh. Bujqësia, në Zonën Kadastrale Fushë-Kosovë;
 - 1.7 Ngastra Kadastrale Nr. 00150-2, në sipërfaqe prej 01.41.40ha, në pronësi të P.sh. Kosova Eksport - N.sh. Bujqësia, në Zonën Kadastrale Fushë-Kosovë;
 - 1.8 Ngastra Kadastrale Nr. 00151-0, në sipërfaqe prej 01.59.30ha, në pronësi të P.sh. Kosova Eksport - N.sh. Bujqësia, në Zonën Kadastrale Fushë-Kosovë;

- 1.9 Ngastra Kadastrale Nr. 00152-0, në sipërfaqe prej 00.43.81ha, në pronësi të P.sh. Kosova Eksport - N.sh. Bujqësia, në Zonën Kadastrale Fushë-Kosovë;
 - 1.10 Ngastra Kadastrale Nr. 00153-0, në sipërfaqe prej 00.22.65ha, në pronësi të P.sh. Kosova Eksport - N.sh. Bujqësia, në Zonën Kadastrale Fushë-Kosovë;
 - 1.11 Ngastra Kadastrale Nr. 00154-0, në sipërfaqe prej 00.35.10ha, në pronësi të P.sh. Kosova Eksport - N.sh. Bujqësia, në Zonën Kadastrale Fushë-Kosovë;
 - 1.12 Ngastra Kadastrale Nr. 00156-0, në sipërfaqe prej 01.00.85ha, në pronësi të P.sh. Kosova Eksport - N.sh. Bujqësia, në Zonën Kadastrale Fushë-Kosovë;
 - 1.13 Ngastra Kadastrale Nr. 00157-0, në sipërfaqe prej 00.15.39ha, në pronësi të P.sh. Kosova Eksport - N.sh. Bujqësia, në Zonën Kadastrale Fushë-Kosovë;
 - 1.14 Ngastra Kadastrale Nr. 00158-0, në sipërfaqe prej 00.84.63ha, në pronësi të P.sh. Kosova Eksport - N.sh. Bujqësia, në Zonën Kadastrale Fushë-Kosovë;
 - 1.15 Ngastra Kadastrale Nr. 00159-0, në sipërfaqe prej 00.91.35ha, në pronësi të P.sh. Kosova Eksport - N.sh. Bujqësia, në Zonën Kadastrale Fushë-Kosovë;
2. Bartja e Ngastrave Kadastrale të cekura nga pika 1.1 deri në pikën 1.15 sipas vendimit në pronësi të komunës i mundësojnë Komunës së Fushë-Kosovës ofrimin e shërbimeve me interes të përgjithshëm publik për ndërtimin e objekteve publike: çerdheve, shkollave, qendrave të mjekësisë familjare, palestrave sportive, parqeve, varrezave, e tjera.

Pika e dytë (2) - Propozim për arritjen e marrëveshjes për ndryshimin e kufijve kadastrale në mes të Komunës së Fushë-Kosovës dhe Komunës së Graçanicës.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim ‘Propozimin për arritjen e Marrëveshjes ndërmjet Komunës së Fushë-Kosovës dhe Komunës së Graçanicës për ndryshimin e kufijve kadastrale’. Komuna e Graçanicës muajin e kaluar e ka aprovuar ‘Propozimin për ndryshimin e kufijve’. Ftoj Kryetarin e Komunës që të na jap sqarime.

Kryetari i Komunës: Kjo është një pikë e rëndësishme që diskutohet për tri vite me radhë, por jo në publik, sepse siç e dini ne jemi dëmtuar me territor me rastin e formimit të komunave të reja, na është marrë Uglari dhe Batusa. Në atë kohë ka tentuar Komuna e Gjilanit të ndryshojë diçka por nuk ka pasur mundësi. Tani territori i Komunës fqinje - Graçanicës vjen deri te hyrja e ndërtesave të lagjes ‘Apollonia’ dhe në pjesën tjetër në Bresje deri afër rrugës Magjistrale M9. Popullsia e kësaj zone nuk i kërkon shërbimet në Komunën e Graçanicës por në Komunën tonë, për shkak të afërsisë ata tek ne i marrin shërbimet shëndetësore, shërbimet e gjendjes civile, etj. Një person, me emrin Musa Gashi, ka kërkuar që rrugës së ndërtuar nga ne t’i vendoset emri i vëllait të tij të vvarë në luftë por këtë nuk kemi mundur ta bëjmë sepse hapësira gjendet në Komunën e Graçanicës, edhe pse i kemi pasur dy takime me ta për këtë çështje! Vendimi i marrë nga Komuna e Graçanicës në muajin e kaluar është vlerësuar në aspektin procedural si Vendim i Ligjshëm nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal. Pas marrjes së vendimit edhe nga ana jonë, ne si Kryetarë të Komunave do ta lidhim një Marrëveshje me Komunën e Graçanicës, mirëpo këto vendime nuk bëhen të plotfuqishme pa ndryshimin e ‘Ligjit për kufijtë administrativ’ që bëhet nga Kuvendi i Kosovës. Në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës pritet të kalojë një pjesë e Zonës Kadastrale të Uglarit dhe një pjesë e Zonës Kadastrale të Preocit, ku bënë pjesë edhe lagjja ‘Marigona’, çka të japim ne marrim. Ne do të bëjmë përpjekje që edhe banorët e fshatit Harilaç i Vogël dhe Vrellë, që tani janë në kuadër të Komunës së Lipjanit, të kalojnë në territorin e komunës

sonë, meqë edhe shkollën dhe shërbimet shëndetësore i kryejnë në fshatin Sllatinë e Madhe. Ne nuk duhet të merremi me paragjykime dhe teori konspirative, nuk duhet të paragjykojmë të ardhmen nëse kemi mundësi reale që ta rrisim territorin e Komunës sonë, qoftë edhe për pak hektarë tokë.

Shaban Ademi: Unë nuk mendoj se Komuna e Graçanicës janë aq zemërgjerë që të na dhurojnë neve 24 hektarë tokë pa e pasur interesin e tyre! Po të ishte interesi praktik në pyetje ata nuk do të na lejonin të ishim as lagjja e Halilve në fshatin Henc me 150 votues, por ata i kanë interesat e veta politike në kuadër të projekteve të tyre!. Vërejtjet e mia janë se këtu ata nuk kanë të bëjnë me ndonjë gabim por e kanë të qartë qëllimin e tyre politik, kurse komuna jonë ka qëllime tjera. Edhe në Komunën e Graçanicës opozita atje ka votuar kundër 'Propozimit për ndryshimin e kufijve kadastralë me Komunën e Fushë-Kosovës'.

Durim Hajra: 'Propozimi për ndryshimin e kufijve kadastralë në mes të Komunës së Fushë-Kosovës dhe Komunës së Graçanicës' nuk ka bazë ligjore, është antikushtetues dhe synon krijimin e 'Komunës monoetnike', sepse ata tentojnë të bartin në territorin tonë lagjet ku mbi 90% e popullsisë janë shqiptar! Pyes, pse nuk na e kthejnë Batusën me popullatë shumicë serbe dhe pjesën tjetër të fshatit Uglar që është afër Fushë-Kosovës, dhe me Komunën e Graçanicës e ndan vetëm rruga?! Vendimi që ka kaluar në Komunën e Graçanicës është antiligjor dhe antikushtetues dhe besojmë që nuk do të kalojë në Kuvendin e Kosovës, por nëse kalon në këtë çështje do ta dërgojmë në Gjykatën Kushtetuese! Edhe baza ligjore, së cilës ju i jeni referuar, nuk përkon fare me Ligjin për kufijtë administrativ, prandaj ne si Grup Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje jemi kundër aprovimit të këtij propozimi!

Driton Ademi: Para se t'i bëjë analizë Qeverisë në nivelin qendror Kryetari i Komunës duhet të lexojë dhe kuptojë disa kompetenca të nivelit lokal që janë në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi, ku thuhet se: 'Komuna nuk bart pronë dhe territor, ndërsa kufijtë administrativ korrespondojnë me zonat kadastrale dhe kufijtë shtetëror'. Shërbimet merren përmes dixhitalizimit të programeve dhe kjo nuk ka të bëjë shumë me ofrimin e shërbimeve për dy zona të vogla kadastrale, Uglarit dhe Preocit, këtu më shumë kemi të bëjmë me përmirësimin e etnitetit në letër për komunitetin serb sesa për rregullimin e mirëqenies së qytetarëve dhe ofrimin e shërbimeve për ta!

Remzi Shala: Në institucionin tonë shëndetësor marrin shërbime të gjithë qytetarët nga zona e Uglarit dhe mendoj se kjo punë është e ligjshme sepse nëse nuk është e tillë në aspektin juridik nuk do të pranohet nga Kuvendi i Kosovës. Ne duhet të provojmë që të realizojmë rritjen e territorit tonë, ofrimin e kushteve dhe shërbimeve sa më të mira shëndetësore dhe sociale për qytetarët e komunës tonë.

Naser Graiçevci: Përsëritet të pranishmit në mbledhje. Unë dua të debatoj për këtë temë të madhe dhe të rëndësishme për dy komunat tona. Po thuhet se ky propozim ka kaluar në Komunën e Graçanicës. Unë nga pak po i shoh disa harta, këtu kemi të bëjmë me një qasje joracionale që po tentohet të vendoset në këndvështrimin e ofrimit të shërbimeve më të mira për qytetarë, që duhet të jemi plotësisht dakord por ky ndryshim pritet të krijojë ndarje në shtëpitë e banimit brenda lagjes me vetëm 5 metra largësi të cilat mbesin në Komunën e Graçanicës, ndërsa neve na jepet një lagje që është shumë më larg, siç është lagjja 'Marigona'! Ne, me vite, së bashku me anëtarin e Kuvendit të Komunës, znj. Aida Alimi, kemi kërkuar që të vendosen disa modalitete për regjistrimin e banorëve që jetojnë në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, me synim që t'i rrisim të hyrat dhe

fondin qeveritar për qeverinë tonë lokale, mirëpo kjo kërkesë nuk është realizuar! Arsyeja që më bën të jem kundër këtij propozimi ka të bëjë edhe më këndvështrimin e rëndësisë së kësaj zone si biznes dhe troje të përshtatshme për oligarkët e mëdhenj, ndërsa nga këndvështrimi politik vlen ajo që tha Kryetari dhe anëtarët e Nismës Socialdemokrate në Kuvendin e Kosovës. Ne si qytetarë tani po dëgjojmë debatin për korigjimin e kufijve, që paraqet një eksperiment dhe lidhet me fatin e Kosovës! Kosova është një projekt ndërkombëtar i rendit të ri botëror dhe në bashkëpunim me faktorin ndërkombëtar e ka realizuar pavarësinë e saj. Asnjëri nga popujt ballkanikë pa përkrahjen direkte apo indirekte të faktorit ndërkombëtar nuk mund të aneksojë ndonjë pjesë të popullit fqinj. Këtë e ka dëshmuar edhe konferenca dhe konfrontime të vazhdueshme që nga Londra, Versaja, etj., që është dashur një shekull për ta ndryshuar padrejtësinë historike ndaj popullit tonë! Me një fjalë, asnjë ndryshim te popujt ballkanikë nuk mund të bëhet pa vulën e fuqive ndërkombëtare. Kosovën, në territorin e saj, me këta kufij, që është në proces të formësimit të shtetësisë së saj, e kanë pranuar 120 shtete. Këto çështje të brendshme tani paraqesin një paradoks! Në nivelin qendror Lidhja Demokratike e Kosovës është kundër korigjimit të kufijve, edhe vetë Kryetari i Komunës e tha se: 'Kryeministri ishte i yni por nuk na e kreu punën për çështjen e pronave!' Çështja e rritjes së territorit dhe zgjerimit të kufijve është e njëjtë që nga Roma e lashtë e deri te koha e Ali Pashë Tepelenës. Mua sot po më pengon qasja ndryshe që lidhet me financa dhe ekonomi, thuhet se: 'ne do ta zgjerojmë territorin edhe me Vrellën e Harilaçin e Vogël', mirëpo ky qëndrim nuk përcakton faqen momentale që ndërlidhet vetëm me aspekte ekonomike sepse pa u bërë shtetformimi i plotë i Kosovës ndryshimet brenda komunave do ta dëmtojnë procesin politik të Kosovës! Ju duhet ta dini se me këtë qëndrim të ndryshimit të hartave për 24 hektarë Komuna e Graçanicës synon të ndryshojë planin e Marti Ahtisarit lidhur me kufijtë komunal! Juve ju urojmë punë të mbarë por ne jemi kundër këtyre veprimeve të pamenduara dhe të paanalizuara mirë!

Ljubisha Qirkoviç: Përsëritës të pranishmit në mbledhje. Pyes, sa është sipërfaqja që do të merret nga Zona Kadastrale e Uglarit dhe Preocit afër lagjes 'Marigona'?

Kryetari i Komunës: Kjo çështje është ligjore, është e drejtë e Kuvendit të Komunës që të marrë iniciativë të tillë, ndërsa ndryshimi i Ligjit për Kufijtë Administrativ është çështje e brendshme e Kosovës. Unë pajtohem me ata që thonë se ndryshimi i kufijve shtetëror të Kosovës nuk duhet të bëhet. Ndryshimi i kufijve komunal nuk e prek Kushtetutën por bëhet me ligj. Ligjshmëria e vendimit tonë verifikohet nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal. Kjo punë bëhet për të ofruar shërbime më të mira për qytetarët dhe bizneset, ne planifikojmë që afër lagjes 'Marigona' të bëjmë edhe katër apo pesë lagje të reja.

Aida Alimi: Kjo ndarje nuk është e drejtë sepse vendos pronat e qytetarëve 10 ari brenda Komunës së Graçanicës dhe pesë ari në Komunën e Fushë-Kosovës, andaj ne nuk jemi dakord që të bëhet një ndarje e tillë, pa një analizë të mirëfilltë!

Bashkim Krasniqi: Përsëritës të pranishmit në mbledhje. Në parim ne e mbështesim bashkëpunimin ndërmjet dy komunave që do të ndikojë në zhvillimin e komunës tonë duke rritur të hyrat vetjake nga tatimi në pronë dhe realizimin e projekteve të reja në të mirë të qytetarëve. Vendimi i marrë nga Komuna e Graçanicës është konfirmuar si i ligjshëm dhe besojmë që edhe vendimi ynë duhet të konfirmohet si i tillë, andaj e përkrahim propozimin në fjalë.

Mehdi Lahu: Përsëritës të pranishmit në mbledhje. Sa i përket këtij propozimi i kemi dy qasje. Komuna jonë synon të ofrojë shërbime më të mira për qytetarët, ndërsa Komuna e Graçanicës ka qasje politike. Në aspektin praktik Kryetari i Komunës ka të drejtë në aktivitetin e tij por kur shikohet se cilat pjesë do t'i dhurohen Komunës së Fushë-Kosovës ne jemi kundër aprovimit të këtij propozimi.

Ilir Hasani: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Kjo pikë e rendit të ditës në aspektin ekonomik për komunën tonë është më e favorshme sepse e rrit buxhetin dhe të hyrat vetjake që mund të ndikojë në punësimet e reja në arsim, shëndetësi dhe administratë.

Sabit Bullatovci: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë flas në emrin tim personal me qëllimin më të mirë, këtu nuk kemi të bëjmë me 170 hektarë tokë por vetëm me 17 hektarë. Preoci më herët ka qenë në kuadër të Prishtinës, te lagjja 'Marigona' janë vetëm 34 hektarë, ku prona është private. Në kohën kur neve na janë marrë 1000 hektarë tokë unë i kam thënë z. Murat Mehës që të kenë kujdes, por atëherë përfaqësuesit tonë kanë shkuar në bisedime me duar në xhepa dhe janë shkaktuar dëme me rastin e vizatimeve të hartave! Sa i përket 'Zonës Industriale' ne kemi telashe me Komunën e Prishtinës që nga viti 1989. Çdo marrëveshje për ndryshimin e kufijve duhet të miratohet me dy të tretat e votave të Kuvendit të Kosovës. Në aspektin politik ne nuk humbim asgjë por nuk na korrigjohen dëmet që na janë shkaktuar edhe nga rruga Magjistrale M9. Pas sqarimeve, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim 'Propozimin për arritjen e Marrëveshjes ndërmjet Komunës së Fushë-Kosovës dhe Komunës së Graçanicës për ndryshimin e kufijve kadastralë'.

U votua me: pesëmbëdhjetë vota 'për', nëntë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej njëzet e katër anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me shumicë të votave, e aprovoi 'Propozimin për arritjen e Marrëveshjes ndërmjet Komunës së Fushë-Kosovës dhe Komunës së Graçanicës për ndryshimin e kufijve kadastralë' dhe mori:

V E N D I M

Për miratimin e Propozimit të Kryetarit të Komunës për iniciimin e procedurave ligjore për rregullimin e ndërsjellë të vijave kadastrale, ndërmjet Komunës së Fushë-Kosovës dhe Komunës së Graçanicës për Zonat Kadastrale të Uglarit dhe Preocit, për ndryshimin e kufijve në të ardhmen për njësitë kadastrale dhe patundshmëritë të ndërtuara mbi to, numrat dhe sipërfaqet e të cilave janë të identifikuara në listën që është pjesë e këtij vendimi, do të jenë në kuadër të Zonave Kadastrale të Komunës së Fushë-Kosovës.

Pika e tretë (3) - Propozim për formimin e Komisionit për ndarjen e nxënësve sipas lagjeve dhe rrugëve për vijueshmërinë e mësimi në shkollat e qytetit.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për themelimin e 'Grupit Punues për ndarjen e nxënësve sipas lagjeve dhe rrugëve', ku në këtë grup punues do të jenë përfaqësuesit e Legjislativit, Ekzekutivit dhe Këshillit të Prindërve.

Kryetari i Komunës: Kohën e fundit jemi të njoftuar se është bërë lëvizja e 1400 nxënësve nga shkolla 'Mihal Grameno' në objektin e ri të shkollës 'Daut Bogujevci'. Për tejkalimin e problemeve në këtë fushë ne synojmë që ta krijojmë një Grup Punues që do të merret me riorganizimin e nxënësve në shkollat e qytetit sipas lagjeve dhe rrugëve. Ky Grup Punues do të jetë gjithëpërfshirës dhe do të merret me riorganizimin e nxënësve të klasave të para për vitin e ardhshëm shkollor dhe punën e tij duhet ta kryej deri në fillim të muajit qershor 2019.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: Nga Kuvendi i Komunës secili subjekt politik do të përfshihet me nga një përfaqësues në Grupin Punues.

Eglantina Azemi: Ndarja dhe riorganizimi i nxënësve sipas lagjeve dhe rrugëve në qytetin e Fushë-Kosovës është propozim i yni dhe mendojmë se kjo do ta zgjidhë çështjen për një kohë deri në funksionalizimin e objektit të ri shkollor në lagjen e 'Dardanisë' afër banesave të 'Kompleksit 300'.

Driton Ademi: Për çdo vit shkollor komuna jonë bën eksperimente! Nuk ka një politikë makro për zhvillimin e arsimit! Ndryshimet në qytet me ndërtime të larta nuk janë përcjellë me punë adekuate në ndërtimin e objekteve shkollore! Janë bërë zgjidhje parciale, ad-hoc, andaj Nisma Socialdemokrate është kundër zgjidhjeve të tilla!

Aida Alimi: Unë e kam cekur edhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë e Financa se ne e përkrahim aprovimin e këtij propozimi që synon të krijojë një zgjidhje në arsim për një periudhë të shkurtër kohore.

Mehdi Lahu: Në komunën tonë problemet në arsim janë të mëdha dhe ne kemi vështirësi për t'i zgjidhur ato! Andaj kërkojmë që Grupi Punues të jetë profesional dhe të merret seriozisht me zgjidhjen e çështjes deri në muajin qershor. Unë më herët kam propozuar që nëpër shkolla të bëhen dollap për çanta të nxënësve sepse pesha e librave është e madhe dhe ndikon në shëndetin e nxënësve.

Kryetari i Komunës: Ne pajtohemi me sugjerimet e anëtarëve të Kuvendit të Komunës por edhe në propozimin tonë e kemi cekur që të krijohet një Grup Punues i gjerë dhe profesional.

Ali Ismaili: Unë pajtohem që propozimi në fjalë të aprovohet, mirëpo kërkoj që unë personalisht të tërhiqem sepse nuk kam kohë që ta jap kontributin si duhet në punën e këtij grupi punues. Është mirë që Grupi Punues do të ketë përfaqësues nga të gjitha subjektet politike dhe të raportojë për punën e tij.

Remzi Shala: Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës për anëtare të Komisionit e propozojmë znj. Vjollca Konjusha.

Durim Hajra: Në emër të anëtarëve të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje për anëtare të Komisionit e propozojmë znj. Eglantina Azemi.

Arijana Zogiani: Në emër të Partisë Demokratike të Kosovës për anëtare të Komisionit e propozojmë znj. Aida Alimi.

Në vazhdim për anëtarë të Komisionit u propozuan edhe: Driton Hasolli, Mehdi Lahu, Migjen Kolshi, Bashkim Krasniqi, Qerim Gara, Drejtori i Arsimit, tre drejtorët e shkollave, tre përfaqësuesit e Këshillit të Prindërve, nga Drejtoria e Gjeodezisë, Kadastrit dhe Pronës - Arta Gërguri dhe nga Drejtoria e Planifikimit Urban - Fatime Ismaili.

Pas sqarimeve, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim 'Propozimin për themelimin e 'Grupit Punues për ndarjen e nxënësve sipas lagjeve dhe rrugëve', në këtë grup punues do të jenë përfaqësuesit e Legjislativit, Ekzekutivit dhe Këshillit të Prindërve si vijon: Vjollca Konjusha, Eglantina Azemi, Aida Alimi, Driton Hasolli, Mehdi Lahu, Migjen Kolshi, Bashkim Krasniqi, Qerim Gara, Islam Shabani, Ismet Gashi, Remzije Bogujevci, Sabri Xhigoli, Laura Neziri, Sherife Aliçkaj, Fitim Zeqiri, Arta Gërguri dhe Fatime Ismaili.

U votua me: njëzet e pesë vota 'për', një 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej njëzet e gjashtë anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me shumicë të votave, e aprovoi 'Propozimin për themelimin e 'Grupit Punues për ndarjen e nxënësve sipas lagjeve dhe rrugëve', me këta anëtarë si vijon: Vjollca Konjusha, Eglantina Azemi, Aida Alimi, Driton Hasolli, Mehdi Lahu, Migjen Kolshi, Bashkim Krasniqi, Qerim Gara, Islam Shabani, Ismet Gashi, Remzije Bogujevci, Sabri Xhigoli, Laura Neziri, Sherife Aliçkaj, Fitim Zeqiri, Arta Gërguri dhe Fatime Ismaili dhe mori:

V E N D I M

1. Për formimin e Grupit Punues për ndarjen dhe caktimin e vijueshmërisë së nxënësve të klasave të para në shkollat fillore të mesme të ulëta në Fushë-Kosovë: 'Mihal Grameno', 'Selman Riza' dhe 'Daut Bogujevci', sipas lagjeve dhe rrugëve nga viti shkollor 2019-2020, në përbërjen si vijon:
 - 1.1 Vjollca Konjusha - Kryesuese e Kuvendit të Komunës, përfaqësuese e Lidhjes Demokratike të Kosovës, anëtare;
 - 1.2 Eglantina Azemi - përfaqësuese e Lëvizjes Vetëvendosje, anëtare;
 - 1.3 Aida Alimi - përfaqësuese e Partisë Demokratike të Kosovës, anëtare;
 - 1.4 Driton Hasolli - përfaqësues i Aleancës Kosova e Re, anëtar;
 - 1.5 Mehdi Lahu - përfaqësues i Partisë Socialdemokrate, anëtar;
 - 1.6 Migjen Kolshi - përfaqësues i pavarur në Kuvendin e Komunës, anëtar;
 - 1.7 Bashkim Krasniqi - përfaqësues i Partisë Liberale Egjiptiane, anëtar;
 - 1.8 Qerim Gara - përfaqësues i Partisë Demokratike të Ashkalinjve të Kosovës, anëtar;
 - 1.9 Ljubisha Qirkoviq - Përfaqësues i Iniciativës Qytetare serbe, anëtar;
 - 1.10 Islam Shabani - Drejtor i Arsimit, anëtar;
 - 1.11 Ismet Gashi - Drejtor i Shkollës Filllore të Mesme të Ulët 'Mihal Grameno', anëtar;
 - 1.12 Remzije Bogujevci - Drejtore e Shkollës Filllore të Mesme të Ulët 'Selman Riza', anëtare;
 - 1.13 Sabri Xhigoli - Drejtor i Shkollës Filllore të Mesme të Ulët 'Mihal Grameno', anëtar;
 - 1.14 Laura Neziri - Kryetare e Këshillit të Prindërve të Shkollës Filllore të Mesme të Ulët 'Mihal Grameno', anëtare;
 - 1.15 Sherife Aliçkaj - Kryetare e Këshillit të Prindërve të Shkollës Filllore të Mesme të Ulët 'Selman Riza', anëtare;
 - 1.16 Fitim Zeqiri - Kryetar i Këshillit të Prindërve të Shkollës Filllore të Mesme të Ulët 'Daut Bogujevci', anëtar;
 - 1.17 Arta Gërguri - Zyrtare për Gjeodezi në Drejtorinë e Gjeodezisë, Kadastrit dhe Pronës, anëtare;
 - 1.18 Fatime Ismajli - Zyrtare për Planifikim Urban në Drejtorinë e Planifikimit Urban, anëtare.
- 2 Detyrë e Grupit Punues është që deri më datë 01.06.2019, të bëjë ndarjen e nxënësve të klasave të para sipas lagjeve dhe rrugëve për vijueshmërinë e mësimit në shkollat fillore të mesme të ulëta të Fushë-Kosovës nga viti shkollor 2019-2020.

Pika e katërt (4) - Propozim për shqyrtimin e kërkesës së Organizatës 'Terre des Hommes' për Qendrën Ditore për mbrojtjen e fëmijëve me qëndrim në rrugë.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Rekomandimin nga mbledhja e Komitetit për Politikë e Financa që objekti publik në oborrin e shkollës 'Selman Riza' të ridestinohet për Arkivin e Komunës'. Hap diskutimin.

Driton Ademi: Ju duhet t'i përmbaheni parimeve që prona komunale të shfrytëzohet për interesin publik, ajo mund të jepet në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë vetëm sipas ligjit. Krijimi i një

Qendre Sociale si ide paraqet një propozim të mirë që synon të përkrah shërbimet sociale për fëmijë.

Mehdi Lahu: Qëllimi i organizatës është i mirë sepse synon të sistemojë dhe kujdeset për fëmijët që qëndrojnë në rrugë meqë objekti në fjalë nuk po ka mundësi të vazhdojë punën si çerdhe e fëmijëve, njësoj siç nuk janë funksionale as dy çerdhet tjera në fshatra! Tani e kemi edhe propozimin që ky objekt të destinohet për Arkivin e Komunës, pyes, a ka mundësi që kësaj organizate t'i jepet objekti publik në fshatin Miradi e Poshtme?

Durim Hajra: Propozimi i Organizatës 'Terre des Homes' është një ide e mirë që synon të sistemojë fëmijët me qëndrim në rrugë për periudhën dyvjeçare. Ne kërkojmë që puna e tyre të mbikëqyret nga Ekzekutivi i Komunës dhe pajtohem që të aprovohet ky propozim meqë objekti publik nuk po shfrytëzohet për çerdhe publike.

Ali Ismaili: Sipas përshkrimit në propozim kjo organizatë për tri ditë ka gjetur se 24 fëmijë janë me qëndrim në rrugë, kjo gjë është alarmante! Kjo çështje kërkon një trajtim dhe analizë por nuk është e ngutshme që të trajtohet në mbledhje të jashtëzakonshme.

Shaban Ademi: Kjo pikë e rendit të ditës nuk duhet të përkrahet sepse janë mbi 8000 Organizata Joqeveritare që misionin e vet e kanë ta gllabërojnë dhe shfrytëzojnë buxhetin e Kosovës! Këto ide të funksionimit të tyre te ne i ka përhapur bashkësia ndërkombëtare dhe tani këto Organizata zhvillojnë aktivitetin e tyre kinse duke u marrë me hallet e popullit tonë që është në gjendje të vështirë ekonomike dhe sociale! Është e vërtetë se fëmijët që qëndrojnë në rrugë paraqesin shqetësim por me këtë punë duhet të merren organet e shtetit.


Pas sqarimeve, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim për shtyrje për shqyrtim në mbledhjen e ardhshme 'Propozimin për shqyrtimin e kërkesës së Organizatës 'Terre des Hommes' për Qendrën Ditore për mbrojtjen e fëmijëve me qëndrim në rrugë dhe rekomandimin e Komitetit për Politikë e Financa që objekti publik – çerdhja e fëmijëve të shndërrohet në arkiv të komunës'. U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej njëzet e gjashtë anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës e shtynë për shqyrtim në mbledhjen e ardhshme 'Propozimin për shqyrtimin e kërkesës së Organizatës 'Terre des Hommes' për Qendrën Ditore për mbrojtjen e fëmijëve me qëndrim në rrugë dhe rekomandimin e Komitetit për Politikë e Financa që objekti publik - çerdhja e fëmijëve të shndërrohet në arkiv të komunës'.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje në mbledhje. Mbledhja përfundoi në orën 10:50 minuta.


Procesmbajtës

Hasan Gjyrevci



Kryesuesja e Kuvendit të Komunës

Vjollca Konjusha



	REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE DIREKTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJO	
Nr.faq/Bilstr. 209		
Datë/Datum. 31.10.2018		
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE		



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË -KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE



Ekstrakt nga procesverbali i mbledhjes së dhjetë X - të, e jashtëzakonshme, e Kuvendit të Komunës, e mbajtur më datë 25.10.2018, ora 09:00h, në sallën e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës.

Prezentë në mbledhje ishin anëtarët e Kuvendit të Komunës: Vjollca Konjusha - Kryesuese e Kuvendit të Komunës, Remzi Shala, Ilir Hasani, Arjeta Jashari, Mirvete Gërguri, Jetmir Berisha, Albert Jasharaj, Miranda Shabani, Sabit Bullatovci, Betim Ahmeti, Sabri Rexhepi, Ali Zogiani, Durim Hajra, Eglantina Azemi, Doruntina Jashari, Aida Alimi, Arjana Zogiani, Naser Graiçevci, Migjen Kolshi, Mehdi Lahu, Shaban Ademi, Driton Ademi, Ali Ismaili, Driton Hasolli, Qerim Gara, Bashkim Krasniqi dhe Ljubisa Qirkoviq.

Kryetari i Komunës dhe Drejtorët e Drejtorive të Komunës: Fadil Krasniqi - Nënkryetar i Komunës, Ekrem Berjani - Drejtor i Zhvillimit Ekonomik, Jakup Tërnavë - Drejtor i Gjeodezisë, Kadastrit dhe Pronës, Afrim Krasniqi - Drejtor i Inspektoratit, Nuriye Avdiu - Drejtore e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Maliq Berisha - Drejtor i Shërbimeve Publike dhe Mjedisit.

Të tjerë: Përfaqësuesit e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, përfaqësuesit e Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës 'Adem Jashari', përfaqësuesit e OSBE-së, KFOR-it, qytetarë dhe mediat.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës përshëndeti të pranishmit në mbledhje, pas verifikimit të prezencës së anëtarëve të Kuvendit të Komunës, konstatoi se ekziston kuorumi për mbajtjen e mbledhjes së jashtëzakonshme dhe prezantoi këtë:

REND DITE

1. Propozim në lidhje me shqyrtimin e ndërtimit të objektit për ruajtjen e përkohshme të mbeturinave të rrezikshme në Kosovë, në Zonën Kadastrale të Harilaçit, sipas vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 11/49, të datës 29.05.2018.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: Përshëndes të pranishmit, anëtarët e Kuvendit, përfaqësuesit e Ministrisë, përfaqësuesit e Ekzekutivit, OSBE-në, KFOR-in dhe mediat. Me ftesë të Kryetarit të Komunës jemi mbledhur sot në këtë mbledhje të jashtëzakonshme me të vetmen pikë të rendit të ditës 'Propozimin për shqyrtimin e ndërtimit të objektit për ruajtjen e përkohshme të mbeturinave të rrezikshme në Zonën Kadastrale të fshatit Harilaç' sipas vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 11/49, të datës 29.05.2018. Ju ftoj që ta përkrahni këtë rend të ditës. Pasi që diskutime tjera nuk pati, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës ftoi anëtarët e Kuvendit të Komunës që të votojnë për aprovimin e rendit të ditës së propozuar. U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej njëzet e shtatë (27) anëtarë. Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me unanimitet, e aprovoi rendin e ditës së propozuar.

Pika e parë (1) - Propozim në lidhje me shqyrtimin e ndërtimit të objektit për ruajtjen e përkohshme të mbeturinave të rrezikshme në Kosovë, në Zonën Kadastrale të Harilaçit, sipas vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 11/49, të datës 29.05.2018.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për shqyrtimin e mundësisë për ndryshimin e vendimit të Qeverisë së Republikës të Kosovës nr. 11/49, të datës 29.05.2018 për ruajtjen e përkohshme të mbeturinave të rrezikshme' të cilës i janë ndërprerë punimet nga inspektorët komunalë dhe kjo punë ka paraqitur një shqetësim të madh për banorët e fshatit Harilaç. Ftoj përfaqësuesin e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor që ta merr fjalën.

Enver Tahiri - Përfaqësues i Ministrisë së MPH-së: Përshëndes të pranishmit, anëtarët e asamblesë komunale dhe të tjerët. Sot jam këtu me porosinë e udhëheqësve të mi që t'ju informoj lidhur me çështjen e projektit për mbeturina të rrezikshme që do të ruhen në ngastrat kadastrale të fshatit Harilaç. Aty planifikohet të ndërtohen disa objekte për magazinimin e përkohshëm të mbeturinave të rrezikshme që sot hedhen kudo dhe nuk ka një sistem të duhur për menaxhimin e tyre. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor po tenton të krijojë një sistem për menaxhimin e mbeturinave të rrezikshme duke i magazinuar të cilat do të ruhen për një kohë para trajtimit të tyre në mënyrën e duhur. Në këto mbeturina bënë pjesë çdo mall që nuk përdoret në shtëpitë dhe institucionet tona, spitalet, laboratorët e ndryshëm, të cilat po krijojnë grumbuj të mbeturinave që paraqesin një shqetësim për ne. Në këtë projekt synohet të krijohet një qendër në Kosovë për grumbullimin e tyre, duke caktuar një vend për trajtim. Projekti në fjalë financohet nga Komisioni Evropian, në shumë prej 13 milionë eurosh, sepse ne nuk kemi mundësi buxhetore për një projekt të tillë! Ata do të na ndihmojnë edhe me ekspertët e tyre, ku një milion euro do të ndahen për mbështetje teknike dhe hulumtimin e lokacionit. Në këtë projekt ka punuar edhe një grup ndërministror. Fillimisht ky projekt është tentuar që të bëhet në vitin 2009 në pronat e ish/ushtrisë jugosllave, ku magazinat e demoluara atëherë ka tentuar t'i pastrojë Trupa Mbrojtëse e Kosovës dhe më vonë t'i detektojë minat Forca e Sigurisë së Kosovës, mirëpo ata kanë mundësi që ta bëjnë këtë punë vetëm në thellësinë deri në 50 cm sepse është supozuar që aty ka predha që mund të eksplodojnë. Komisioni Evropian ka kontraktuar një kompani për hulumtime gjeoteknike në atë zonë për vendin ku po diskutojmë ne sot. Është bërë një hulumtim dhe është konstatuar se aty nuk ka predha në thellësi të mëdha. Komisioni Evropian, përveç ekspertëve për hulumtime gjeoteknike, do të hulumtojë aty edhe hidrologjinë, gjeologjinë dhe gjeostatikën e zonës. Inspektorët tuaj e kanë ndërprerë punën ndërsa tani jemi para një kolapsi të punëve që na duhet ta gjejmë një zgjidhje. Ne insistojmë se lokacioni në fjalë është i qëlluar, projekti në fjalë do të bëhet brenda parametrave dhe standardeve të mira që zbatohen në Bashkimin Evropian. Për këtë çështje do të përgatitet edhe raporti për vlerësimin e ndikimit në mjedis.

Migjen Kolshi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Sot të gjithë jemi mbledhur këtu për ta kundërshtuar vendimin e Qeverisë së Republikës të Kosovës, të datës 29.05.2018 për caktimin e lokacionit për vendosjen e materialeve të rrezikshme. Zona në fjalë, sipas Planit Zhvillimor Komunal 2013-2023, është e destinuar për zonë pyjore dhe këtu nuk duhet të lejohet kjo veprimtari sepse e rrezikon edhe furnizimin me ujë të fshatit Harilaç! Në afërsi të kësaj zone është edhe Kalaja e Harilaçit, caktimi i lokacionit për ndërtimin e stadiumit kombëtar të Kosovës, Aeroporti Ndërkombëtar Adem Jashari vetëm 3 km larg saj, ndërsa sipas ligjit duhet të jetë 4 km larg!

Banorët e fshatrave Harilaç, Harilaç i Vogël dhe lagjja 'Rrafshinat' kërkojnë që kjo punë të mos bëhet aty, lidhur me këtë çështje ata janë të gatshëm edhe të protestojnë.

Durim Hajra: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Vendimi i Qeverisë së Kosovës për vendosjen e përkohshme të mbeturinave të rrezikshme është bërë pa asnjë analizë paraprake! Ajo zonë, edhe me dokumentet e konfirmuara nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, nuk lejohet të shfrytëzohet për veprimtari të tilla, sepse këtë e ndalon ligji! Ushtrimi i kësaj veprimtarie e rrezikon florën dhe faunën. Kjo deponi e ndot ajrin, ujin dhe natyrën, pengon zhvillimin e turizmit në Kalanë e Harilaçit dhe është deponi që na sjell dëmin e sigurt! Pyesni asamblistët se a kalojnë çështje të tilla brenda vendbanimeve në shtetet e Bashkimit Evropian! Për këto çështje ka kundërshtime të mëdha publike, e jo sikur të ne mostransparencë, me arsyetimin e tyre se ky qenka projekt i Bashkimit Evropian! Kush do të na garantojë neve dhe rajonin, po ashtu nivelin qendror dhe lokal, se prapa këtij tenderi ka fshehtësi të mëdha që do ta shkatërrojnë tokën e pyllëzuar dhe ëndrrat tona për zhvillimin e turizmit në atë zonë! Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje është kundër dhe ju bënë thirrje të gjithëve që të ngriheni kundër këtij vendimi të dëmshëm. Këtë dëm po na shkakton Qeveria e Kosovës por nuk amnistohet as qeveria lokale ku reagimi i Kryetarit ka qenë pas reagimit të qytetarëve duke theksuar se nuk kemi qenë në dijeni, arsyetim të cilin ne nuk e besojmë sepse edhe në vitin 2009 nga Qeveria Thaçi-1 është marrë një vendim i tillë, edhe në atë kohë pushtet në komunën tonë ka qenë LDK-ja dhe Burim Berisha! Ne e kemi kundërshtuar në Kuvendin e Komunës edhe vendimin për subjektin afarist 'Kosmonte Foods' ku do të shkatërrohen 2 hektarë pyje në zonën e paraparë për arkeologji dhe zhvillimin e turizmit, mirëpo qëndrimet tona nuk janë marrë parasysh! Reagimi i Kryetarit të Komunës dhe diskutimet e tij pas takimit me Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor se: 'mund të gjendet një lokacion tjetër' ne i themi jo, sepse nuk ka asnjë lokacion dhe vend për një deponi të tillë të mbeturinave të rrezikshme dhe kërkojmë që të gjitha procedurat lidhur me këtë vendim të Qeverisë të shpallen të pavlefshme dhe të ndërpriten punimet.

Nënkryetari i Komunës: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Ajo që u tha nga anëtari i Kuvendit të Komunës nga Lëvizja Vetëvendosje për punimet në fshatin Harilaç nuk qëndron sepse inspektorët komunalë i kanë ndërpre punimet aty. Ekzekutivi i Komunës - Kryetari ka qenë i pari që ka reaguar ndaj këtij vendimi në momentin kur është filluar të punohet aty. Ekzekutivi i Komunës i ka kryer obligimet e veta, pastaj kanë reaguar edhe opozita dhe të gjitha subjektet tjera politike, pa përjashtim.

Remzi Shala: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Vendimin e Qeverisë së Kosovës për caktimin e lokacionit për vendosjen e përkohshme të mbeturinave të rrezikshme në Harilaç e kundërshtoj unë në emrin tim dhe në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, sepse vendosja e tyre aty është në kundërshtim me 'Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit' sepse këto mbeturina toksike, shpërthyesë e ndotin ajrin, ujin, ekosistemin dhe natyrën në tërësi! Ky është një gabim i qeverisë për të cilin Kryetari i Komunës nuk ka qenë i informuar, andaj akuzat e përfaqësuesit të Lëvizjes Vetëvendosje nuk qëndrojnë. Me dokumentet për vlerësimin strategjik mjedisor, në nenet 28, 29, 30, 31, parashihet që të ketë leje mjedisore për zhvillimin e këtyre punimeve, e ne si komunë nuk jemi as të njoftuar! Neni 47 parasheh që çdo person fizik dhe juridik që synon ndërtimin e një deponie të tillë duhet ta ketë edhe planin e mundshëm të aksidenteve, e ne këtë nuk po e shohim, masat parandaluese, raporti i gjendjes së sigurisë duhet të jenë në

dispozicion të publikut. Ekzekutivi dhe Grupi Parlamentar i LDK-së vlerëson se kjo deponi nuk ka vend në këtë zonë dhe do ta kundërshtojmë me të gjitha mjetet.

Driton Ademi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje, përfaqësuesit e ministrisë, anëtarët e Kuvendit dhe mediat. Pas një viti në këtë sallë ne po e kuptojmë se prania e mediave krijon efekt dhe kjo është shumë me rëndësi. Për këtë pikë të rendit të ditës nuk ka një sqarim publik! Qeverisja lokale që nuk punon me qytetarët është mësuar të prodhojë situata të jashtëzakonshme. Në kuptimin deklarativ Kryetari është 'për', dy indikatorë, sipas mendimit tim personal, më bëjnë të mendoj se ekzekutivi nuk është plotësisht kundër nëse merret parasysh performanca e përfaqësuesve të tyre sepse thuhet se mund të ketë propozime të reja për këtë deponi, por vendosja e saj 1 km këndeje apo andej, por brenda Komunës së Fushë-Kosovës, e ka efektin e njëjtë! Relacionet dhe korrespondencat me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në procesin e vendimmarrjes tregojnë se është humbur shumë kohë dhe ka pasur heshtje, neglizhencë! Ky projekt është identifikuar nga roja e pyllit dhe kjo i ka nxitur qytetarët, tani këtu vjen në shprehje elementi populist i kundërshtimit të kërkesës dhe tërheqjes së propozimit vetëm pas sondimit dhe zhvillimit të punimeve në terren! Pushteti e ka lejuar ndotjen e ajrit me vendosjen e metaleve nga bizneset në Miradi të Epërme, kur i shtohet kësaj edhe ndotja e lumenjve 'Sitnicë' dhe 'Drenicë', teprica e dioksidit të karbonit nga Magjistrallja M9 dhe Korporata Energjetike e Kosovës si dhe deponitë aktive dhe pasive del se Fushë-Kosova është e ndotur 100%. Tani vendimi ynë në këtë asamble komunale me konsensus të të gjitha subjekteve politike nuk paraqet një votim të thjeshtë, por dilemën se a jemi që këto materie të rrezikshme të jenë pjesë e trupit tuaj dhe pasardhësve tuaj!

Nënkryetari i Komunës: Sa për informim real, Kryetari i Komunës nuk është sot në mbledhje në mënyrë që të mos ndikojë në vendimin tuaj. Ky është një vendim i disfavorshëm për territorin e komunës sonë. Kryetari ka kërkuar që kjo punë të bëhet në vendet e degraduara, kjo është e vërteta.

Aida Alimi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Ne jemi kundër vendosjes së mbeturinave të rrezikshme, mbetjeve industriale dhe lokalizimin e betonimeve afër vendbanimeve të qytetarëve. Kundërshtimin e tyre për këtë çështje e kanë shprehur edhe banorët e fshatrave Harilaç, Henc dhe Pomozotin të cilët e marrin ujë nga ajo zonë. Sa për informacionin tuaj kjo deponi është tentuar të vendoset në Shqipëri por nuk është lejuar as atje. Ne jemi kundër realizimit të këtij vendimi.

Mehdi Lahu: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Së pari debati me shoqërinë civile dhe ekspertët e fushës nga Kryetari i Komunës së Fushë-Kosovës ka munguar. Ne të gjithë jemi kundër, Kryetari i Komunës, anëtarët e Kuvendit dhe banorët, sepse kjo paraqet një problem për mjedisin tonë. Me cilat kritere u zgjodh Komuna e Fushë-Kosovës për këtë çështje, kur dihet dendësia e popullsisë, afërsia e vendbanimeve, Korporata Energjetike e Kosovës, depot e naftës në Miradi të Epërme?! Pyes, a janë studiuar kapacitetet e Kosovës për trajtimin e këtyre mbetjeve? Deponi të tilla, për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme, nuk i kanë lejuar as shtetet e rajonit, si: Kroacia, Bosnje Hercegovina, Mali i Zi dhe Maqedonia, të cilat industrinë e kanë shumë më të zhvilluar se sa ne! Në Kroaci pas ndërtimit të një deponie të tillë, ajo është shkatërruar nga vetë qytetarët. Është vështirë që ne të besojmë në punën e shteteve që janë të brishta dhe jostabile, por mbetet që këto punë të ndalohen me veprimin e qytetarëve! Shtetet fqinje kanë vendosur taksa për kompanitë që krijojnë mbetje. Tani këtu e kemi edhe deklarinë e Kryetarit 'se mund të ndryshohet lokacioni', mirëpo ne jemi kundër vendosjes së kësaj deponie të rrezikshme në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.

Doruntina Jashari: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Thirrjen e kësaj mbledhjeje ne e kemi kërkuar ditën e hënë kur Kryetari i Komunës është takuar me Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Shpimet e tilla gjeologjike paraqesin rrezik për mjedisin dhe janë në kundërshtim me dispozitat e nenit 28 të 'Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit', ku Qeveria nuk i harmonizon programet e saj me ligjin! Ne kërkojmë që të lexohet mirë ligji, të bëhen analiza paraprake e jo të thuhet se më vonë do ta bëjmë vlerësimin e ndikimit në mjedis! Edhe Konventa Ndërkombëtare e Aarhusit parasheh konsultimin e komunitetit. Kjo çështje kërkon një studim, sepse një vendim i tillë është marrë edhe në vitin 2009, tani përsëritet në maj të vitit 2018 dhe neve na thuhet se nuk duhet ta humbim donacionin prej 13 milionë eurove nga Komisioni Evropian! Po ashtu ju rikujtoj se në këtë Kuvend është marrë edhe një vendim për vendosjen e mbeturinave, në bashkëpunim me një kompani polake, të cilin ne e kemi kundërshtuar. Mirëpo sot nuk kemi të bëjmë me çfarëdo rrezikshmërie, mjafton të lexohet shtojca 3, lista H për rrezikshmërinë e këtyre mbeturinave që na shtyn ta rrisim seriozitetin, sepse vendosja e këtyre mbeturinave është vdekje për ekosistemin, mjedisin, rrit sëmundjet e kancerit dhe na vendos para pyetjes: A jemi ne që ta mbrojmë jetën tonë, apo ta realizojmë një donacion për tekat e dikujt në qeveri?! Ne jemi kundër lokacionit në fjalë dhe çfarëdo lokacioni tjetër afër tij.

Naser Graiçevci: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Kjo punë nuk është një çështje e thjeshtë 'po ose jo'. Qeveria e Kosovës në muajin maj 2018 ka marrë vendim, sot ne jemi në muajin tetor, katër muaj pas vendimet e qeverisë bëhen publike! Kjo çështje është dashur të shqyrtohet në muajin qershor, arsyetimet e dhëna nuk janë të justifikueshme sepse Zyra Ligjore duhet t'i përcjellë vendimet që kanë ndikim në territorin e komunës sonë. Ne nuk e dimë a është bërë kjo si heshtje e qëllimshme apo jo! Ne pajtohemi që, këtu sot, Ministria përfaqësohet nga njerëzit - përfaqësuesit e saj, dhe Kryetari nga Nënkryetari i Komunës, mirëpo përfaqësimi nuk është problem. Problem në vete është qasja ndaj qytetarëve, në këtë rast banorëve të fshatit Harilaç, të cilëve ju erdhi diçka e tmerrshme si nga qielli! Në vend se atyre t'u ofrohet një teleferik i mundshëm, zhvillim i zonës turistike, atyre u ka ardhur e kundërta e saj! Kjo qeverisje lokale ka dhënë leje të ngjashme në kundërshtim me interesat e banorëve lokal. Të tilla janë 'bombat e kurdisura' në fshatin Miradi e Epërme, gjatë këtij viti ka pasur një shpërthim, por për fat na ka ruajtur zoti nga fataliteti! Tani Ministria e Mjedisit ka vendosur ta zbatojë një vendim të gabuar me qëllim të realizimit të një projekti! Për projekte të tilla duhet të ketë studim të fizibilitetit, së paku në tri lokacione, të ketë debat me qytetarë, t'u shpjegohet atyre projekti. Ky projekt nuk ka kaluar në Shqipëri! Institucionet tona nuk kanë pasur një qasje të drejtë ndaj qytetarëve, është koha e fundit që të punohet drejt dhe në interesin e qytetarëve, por jo në këtë formë! Ne e dimë se në Evropë edhe nëpër qendra urbane ka trajtim të mbeturinave, por atje këto projekte analizohen mirë nga ekspertët dhe nuk paraqesin rrezik për mjedisin.

Nënkryetari i Komunës: Nga marrja e vendimit kanë kaluar 5 muaj, mirëpo ne nuk jemi informuar nga Qeveria e Kosovës, këtë e kemi kuptuar më datë 16.10.2018 kur inspektorët kanë intervenuar në terren për ndalimin e punimeve. Ne jemi kundër lokacionit në këtë zonë afër fshatrave tona. Nëse Qeveria e Kosovës dëshiron që të mos e humb donacionin prej 12 milionë eurosh le të gjejë një lokacion tjetër më të përshtatshëm.

Sabri Rexhepi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Qytetarët e Harilaçit nuk e meritojnë një veprimtari të tillë që në afërsinë e shtëpive të tyre të banimit të vendoset një objekt që trajton mbeturina të rrezikshme dhe kjo çështje nuk lidhet me 'po ose jo', sepse Fushë-Kosova është e

atakuar mjaft edhe me 'bomba' tjera të kurdisura në fshatin Miradi e Epërme, siç u tha nga parafolësit e mi. Në atë zonë pritet të ndërtohet edhe Stadiumi Kombëtar i Kosovës, andaj ne kësaj pune i themi një 'Jo të madhe'.

Ilir Hasani: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Banorët e fshatit Sllatinë e Madhe e kanë kundërshtuar këtë projekt dhe kërkojmë që puna aty të ndalohej që ky objekt për mbeturina të rrezikshme të mos lejohet të vendoset në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.

Driton Hasolli: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Ne e kundërshtojmë fuqishëm vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 11/49 për vendosjen e mbeturinave të rrezikshme sepse Fushë-Kosova e ka ajrin mjaft të ndotur nga termocentralet dhe komunikacioni i dendur ku në territorin tonë po ashtu gjendet edhe aeroporti, andaj ne nuk e pranojmë këtë projekt dhe i themi një 'Jo të madhe' edhe si Legjislativ i Komunës edhe si Ekzekutiv i Komunës.

Ariana Zogiani: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Vendimi i Qeverisë së Kosovës duhet të anulohet sepse ne nuk do të lejojmë që të vendosim materie toksike sepse zona në fjalë ka materie radioaktive dhe në zonën përreth e kanë gjetur vdekjen mbi 20 persona gjatë bombardimeve të NATO-s pas luftës, duke rënë në zona të minuara! Andaj, kërkojmë që të mos lëndohen gjeneratat e reja dhe jemi kundër këtij projekti me rrezikshmëri të madhe për banorët e fshatit Harilaç!

Shaban Ademi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Fushë-Kosova deri tani ka qenë në një terr informativ, prania e mediave sot në këtë mbledhje e rrit seriozitetin. Lidhur me çështjen e deponisë u tha gjithçka nga parafolësit e mi. Unë jam kundër jo vetëm që ky objekt të ndërtohet në komunën tonë por askund në Kosovë, sepse në Shqipëri ndërtimi i këtij objekti është ndaluar nga presioni i autoriteteve vendore dhe qytetarët. Fushë-Kosova është një territor i vogël, me më pak se 100 km² (katrorë) andaj ne nuk mund të rrezikojmë shëndetin e banorëve tanë dhe kërkojmë që ftesat për çështje të tilla të bëhen me kohë e jo vetëm pas sensibilizimit të situatës!

Betim Ahmeti: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë si qytetar i Fushë-Kosovës, dhe të gjithë ne në Kuvendin e Komunës, duhet të jemi unik ndaj kundërshtimit të së keqes. Përfaqësuesi i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor e sqaroi pak këtë çështje, mirëpo Fushë-Kosova ka edhe shumë probleme tjera, siç është edhe ngarkesa e madhe në komunikacion, ngase është neglizhuar në aspekte të ndryshme nga pushteti qendror! Kjo çështje nuk duhet të na ndaj në pozitë dhe opozitë sepse edhe ju i nderuari parafolës i imi këtu kemi ardhur me vota e Lidhjes Demokratike të Kosovës, ndërsa tani veproni si i pavarur, për arsye tuaja! Unë kalimin tim në Grupin Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës e kam deklaruar dhe sqaruar para anëtarëve të Kuvendit të Komunës.

Ali Ismaili: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Tani pothuajse u shter debati. Kjo deponi për mbeturina të rrezikshme nuk e ka fare vendin në komunën tonë. Ne, në njërin anë, veç e kemi 'bombën' tjetër - Deponinë e Mirashit ndërsa Kryeministri pa e vizituar asnjëherë Komunën e Fushë-Kosovës, për t'u njohur me çështjet dhe problemet e 34 mijë banorëve, sipas regjistrimit të popullsisë dhe 60 mijë banorëve në realitet, është e dhimbshme të tentojë që edhe në anën tjetër të na vendos një 'bombë të re' - vetëm për realizimin e një projekti prej 12 milionë eurosh! Këtë çështje e rregullon edhe një Udhëzim Administrativ i vitit 2009. Vendosja e mbeturinave të rrezikshme nuk lejohet të bëhet në perimetrin e aeroportit që duhet të jetë së paku 4000 metra. Këtu nuk është faji i Bashkimit Evropian që na jep këtë grand por mungesa e analizës paraprake! Për mua nuk është me rëndësi a është thirrur mbledhja e jashtëzakonshme nga Kryetari apo të tjerët, e rëndësishme është që të reagohej shpejt sepse tani jemi tepër vonë! Të jemi unik në kundërshtimin tonë demokratik dhe ligjor për refuzimin e vendosjes së mbeturinave të rrezikshme në territorin e komunës tonë nga ky vendim ad-hoc i Kryeministrit të Kosovës, andaj i bëjmë thirrje që ta tërheq këtë vendim.

Ermira Elshani - Përfaqësuese e Aeroportit: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Aeroporti Ndërkombëtar 'Adem Jashari' është pjesë e ndjeshme në këtë zonë, ku operimet tona duhet të bëhen në bazë të standardeve ndërkombëtare. Lidhur me këtë proces ne jemi informuar përmes rrjeteve sociale se aty do të vendoset një lloj i deponisë me mbeturina të rrezikshme! Kjo është në kundërshtim me rregullat e Aviacionit Civil sepse një deponi e tillë duhet të jetë 500 metra larg shtëpive, 2 000 metra larg rrjeteve të ujësjellësit dhe spitaleve dhe së paku 4 000 metra jashtë perimetrit të aeroportit, në rastin konkret largësia është rreth 3000 metra! Siguria e aeroportit ka pak probleme gjatë fluturimeve edhe për shkak të zogjve që gjenden në zonën afër liqenit të fshatit Henc, po ashtu në këtë pjesë janë edhe pusët që furnizojnë me ujë fshatrat Vrellë, Henc dhe Harilaç. Aeroporti Ndërkombëtar është certifikuar nga institucionet ndërkombëtare, gjendet në territorin e Fushë-Kosovës, sipas nenit 7, paragrafi 1 dhe 2. Ne e kemi për obligim që ta mbrojmë zonën përreth, banorët të vetëdijesohen për neutralizimin e efekteve të dioksidit të karbonit që paraqesin rrezik për punë normale dhe operimin tonë. Mbeturinat e rrezikshme mund të kenë ndikim edhe në pengimin e radarëve dhe zhvillimin e florës dhe faunës, andaj kërkojmë që ky projekt të mos realizohet sepse paraqet pengesë për punën dhe zhvillimin e aeroportit sipas standardeve ndërkombëtare të Aviacionit Civil ku edhe ne jemi anëtarë.

Jetmir Berisha: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Këtu kemi të bëjmë me një vendim të shpejtë, pa u analizuar fare nga ministria përgjegjëse! Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor është dashur që neve të na jap si dhuratë 'Ligjin për Fushë-Kosovën', siç e ka bërë 'Ligjin për Obiliqin' për shkak se edhe territori ynë është shumë i ndotur, andaj ne duhet të jemi unik në këtë çështje duke i mbrojtur interesat e qytetarëve. Institucionet qendrore duhet ta dinë se kjo komunë e ka një zot të shtëpisë dhe ai është Kryetari i Komunës, z. Burim Berisha.

Enver Tahiri - Përfaqësues i Ministrisë: Unë i dëgjova diskutimet tuaja, vendimi është i juaji, mirëpo kjo deponi është në përputhje me direktivat e Bashkimit Evropian. Magazinimi i mbeturinave aty do të bëhet me kushte të veçanta dhe nuk paraqet rrezik, aty do të ruhen mbeturinat për disa muaj, një vit apo tri vite! Nuk do të ketë import të mbeturinave. U përmend nga parafolësit se kjo deponi nuk është lejuar të vendoset as në Shqipëri, këtu është bërë një lëshim procedural sepse nuk është kryer me kohë raporti për vlerësimin e ndikimit në mjedis. Në këtë objekt parashihet të grumbullohen mbeturinat e vendosura nëpër livadhet tona, bateritë, poçet elektrike, mbetjet nga laboratorët dhe ato do të menaxhohen në këtë magazinë në përputhje me standardet evropiane. Bashkimi Evropian do të konstatojë se ne nuk po i zbatojmë ligjet! Unë mendoj se të njëjtin problem mund ta kemi edhe në ndonjë asamblë tjetër komunale sepse kjo çështje për njerëzit paraqet shqetësim, mirëpo duhet t'ju jepet hapësirë profesionistëve për sqarimin e problematikës në fjalë.

Ali Ismaili: Ekipi profesional duhet të krijohet për mbështetjen e këtyre projekteve nga Zyra e Kryeministrit, por këtu kemi të bëjmë me vendin e gabuar sepse në njërin anë gjendet Deponia e Mirashit në anën tjetër Aeroporti Ndërkombëtar, andaj kërkojmë që Kryeministri i Kosovës, z. Ramush Haradinaj të gjejë një lokacion tjetër të përshtatshëm në Kosovë në vendet e degraduara dhe të mbuluara me ferra, larg vendbanimeve.

Sabit Bullatovci: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë këtu tani nuk dua të flas si asamblast por si qytetar. Së pari, sipërfaqja e Fushë-Kosovës është shumë e vogël dhe shumica këtu nuk janë duke e ditur as lartësinë mbidetare të komunës tonë! Në fshatin tonë, Miradi e Poshtme, unë dhe qytetarët jetojmë me ankth sepse niveli qendror na sjell mbetje nga Spanja! Unë nuk e kuptoj se si i humbëm vlerat që i kishim deri në vitin 1999 dhe nga institucionet tona të merren vendime të dëmshme në maj të vitit 2018, kjo është e papranueshme! Ne e kuptojmë se këto mbeturina janë

tonat por territori i Komunës së Fushë-Kosovës, por edhe i 30 komunave tjera të shtetit tonë nuk mund ta pranojnë një gjë të tillë, andaj ne nuk pajtohemi dhe e kundërshtojmë këtë çështje!

Pas sqarimeve, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim 'Propozimin për fillimin e ndërtimit të objektit për ruajtjen e përkohshme të mbeturinave të rrezikshme në Kosovë në Zonën Kadastrale të Harilaçit në njësitë kadastrale Nr. P-72514003-00022-16, P-72514003-00022-17, P-72514003-00022-18 dhe P-72514003-00022-19, sipas vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 11/49, të datës 29.05.2018'.

U votua me: asnjë votë 'për', njëzet e gjashtë vota 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej njëzet e gjashtë anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me shumicë të votave, e refuzon 'Propozimin për ndërtimin e objektit për ruajtjen e përkohshme të mbeturinave të rrezikshme në Kosovë në Zonën Kadastrale të Harilaçit në njësitë kadastrale Nr. P-72514003-00022-16, P-72514003-00022-17, P-72514003-00022-18 dhe P-72514003-00022-19, sipas vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 11/49, të datës 29.05.2018' dhe mori:

V E N D I M

Për refuzimin e ndërtimit të objektit për ruajtjen e përkohshme të mbeturinave të rrezikshme në Kosovë në Zonën Kadastrale të Harilaçit në njësitë kadastrale Nr. P-72514003-00022-16, P-72514003-00022-17, P-72514003-00022-18 dhe P-72514003-00022-19, sipas vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 11/49, të datës 29.05.2018.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje në mbledhje. Mbledhja përfundoi në orën 10:55 minuta.

Procesmbajtës

Hasan Gjyrevci



Kryesuesja e Kuvendit të Komunës

Vjollca Konjusha

